



RAPORTI I MBIKËQYRJES | **2022**
SUPERVISION REPORT

TREGU I SIGURIMEVE, I FONDEVE TË PENSIONEVE VULLNETARE, I FONDEVE TË INVESTIMEVE
INSURANCE, VOLUNTARY PENSIONS FUNDS, INVESTMENTS FUNDS MARKET

PËRMBAJTJA

I.	Misioni i Mbikëqyrjes	5
II.	Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Sigurimeve	6
	1. Struktura e Tregut të Sigurimeve	6
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve	6
	3. Analiza e Ecurisë dhe Rreziqeve të Tregut të Sigurimeve	10
III.	Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	12
	1. Struktura e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	12
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	13
	3. Treguesit Teknikë e Financiarë të Tregut të Fondeve të Pensioneve Vullnetare	13
IV.	Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Fondeve të Investimeve	14
	1. Struktura e Tregut të Fondeve të Investimeve	14
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Investimeve	14
	3. Treguesit Kryesorë të Tregut të Fondeve të Investimeve	15
V.	Tregu i Kapitaleve	16
	1. Tregu i Obligacioneve të Shoqërive Aksionare (Obligacionet e Emetuara me Ofertë Private)	16
	2. Tregu i Rregulluar	17
	3. Zhvillime në përmirësimin e Infrastrukturës së Tregut	18
VI.	Anekse	19
	A. Tregu i Sigurimeve, 31.12.2022	19
	B. Tregu i Fondeve të Pensioneve Private Vullnetare, 31.12.2021	81
	C. Tregu i Fondeve të Investimeve, 31.12.2022	89
	D. Shoqëritë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	119





TABLE OF CONTENTS

I.	<i>Supervision Mission</i>	5
II.	<i>Report on the Financial Position of the Insurance Market</i>	6
	1. <i>Insurance Market Structure</i>	6
	2. <i>Insurance Market Supervision</i>	6
	3. <i>Analysis of Insurance Market Performance and Risks</i>	10
III.	<i>Report on the Financial Position of the Voluntary Private Pension Market</i>	12
	1. <i>Voluntary Private Pensions Market Structure</i>	12
	2. <i>Voluntary Private Pension Market Supervision</i>	13
	3. <i>Technical and Financial Indicators on the Voluntary Pension Funds</i>	13
IV.	<i>Report on the Financial Position of the Investment Fund Market</i>	14
	1. <i>Investment Funds Market Structure</i>	14
	2. <i>Investment Funds Market Supervision</i>	14
	3. <i>Key Indicators of the Investment Funds Market</i>	15
V.	<i>Capital Market</i>	16
	1. <i>Corporate Bonds Market (Bonds Issued via Private Placements)</i>	16
	2. <i>Regulated Market</i>	17
	4. <i>Market Infrastructure Improvements</i>	18
VI.	<i>Annexes</i>	19
	A. <i>Insurance Market, 31.12.2022</i>	19
	B. <i>Voluntary Private Pension Funds Market, 31.12.2022</i>	81
	C. <i>Investment Funds Market, 31.12.2022</i>	89
	D. <i>Pension Funds' and Collective Investment Undertakings' Management Companies</i>	119



I. Misioni i Mbikëqyrjes

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është autoritet mbikëqyrës dhe rregullator i integruar i tregut të sigurimeve, të titujve, të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të pensioneve private vullnetare në Shqipëri. AMF i ushtron funksionet mbikëqyrëse mbështetur në Ligjin nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar me Ligjin nr. 54/2014.

Misioni themelor i Autoritetit është të sigurojë funksionimin efektiv të tregjeve financiare jobankare nën mbikëqyrje, si dhe stabilitetin, promovimin dhe zhvillimin e tyre. Objektivi parësor i Autoritetit është mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit. Në ushtrimin e veprimtarisë rregullative dhe mbikëqyrëse, AMF udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit.

Në përmbushje të veprimtarisë mbikëqyrëse, AMF në vazhdimësi ka përmirësuar kuadrin rregullativ mbikëqyrës në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane. Mbikëqyrja realizohet nëpërmjet bashkërendimit të analizës së dokumentacionit financiar dhe mbikëqyrjes në vend të tregut, orientimit drejt mbikëqyrjes me bazë rreziku, ndërmarrjes së politikave zhvilluese për tregun, si dhe rritjes së kapaciteteve për një mbikëqyrje efektive.

I. Supervision Mission

The Albanian Financial Supervisory Authority (AFSA) is the integrated supervisory and regulatory authority of the insurance, securities, collective investment undertakings and voluntary private pensions market in Albania. AFSA conducts its supervisory functions pursuant to Law No. 9572, dated 03.07.2006, “On Financial Supervisory Authority”, as amended by Law No. 54/2014.

AFSA’s main mission is to ensure effective performance of the non-bank financial markets under supervision, as well as maintain their stability, promotion and sound development. AFSA’s principle objective is to protect the interests of consumers and investors. While performing the regulatory and supervisory activities, AFSA is guided by the principles and norms of independence, transparency and integrity.

In order to fulfill its supervisory activity, AFSA has continuously improved the supervisory regulatory framework in compliance with the international principles and European directives. Supervision is carried out through the coordination of financial documentation analysis and on-site market supervision, orientation towards risk-based supervision, undertaking of development policies for the market, as well as increase of capacities for an effective supervision.

II. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Sigurimeve

1. Struktura e tregut të sigurimeve

Gjatë vitit 2022 në tregun e sigurimeve ushtruan veprimtarinë e tyre 12 shoqëri sigurimi Jetë dhe Jo-Jetë. Në strukturën e tregut, tetë shoqëri sigurimesh ushtrorjnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jo-Jetës dhe katër në sigurimet e Jetës. Një nga shoqëritë e Jo-Jetës është gjithashtu e licensuar për të ushtruar edhe aktivitetin e risigurimit. Duke ruajtur të njëjtën tendencë si në vitet e kaluara, bazuar në pasqyrën e llogarisë teknike të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, edhe gjatë vitit 2022 vihet re se tregu i sigurimeve vazhdon të dominohet nga produktet e sigurimeve të detyrueshme dhe në veçanti nga portofoli i MTPL-së së brendshme.

2. Mbikëqyrja e tregut të sigurimeve

Në tërësi, tregu i sigurimeve u paraqit i qëndrueshëm në terma të treguesve kryesorë të shëndetit financiar, me tregues të mirë likuiditeti, të aftësisë paguese si edhe të mbulimit me provigjone teknike.

Totali i aktiveve të tregut të sigurimeve arriti në rreth 43.6 miliardë lekë, dhe në raport me PBB-në rezultoi të jetë 2.04% në 31.12.2022. Rreth 88% e totalit të aktiveve zotërohen nga shoqëritë e tregut të Jo-Jetës dhe 12% i përkasin shoqërive të tregut të Jetës.

Në 31.12.2022 investimet të cilat rezultojnë me vlerë 30.6 miliardë lekë kanë vijuar të dominojnë totalin e aktiveve të tregut të sigurimeve, duke zënë rreth 70% të totalit të tyre. Rritja e investimeve krahasuar me vitin paraardhës është 3 miliardë lekë ose 11% më shumë krahasuar me një vit më parë.

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve gjatë vitit 2022 u rritën me 9.21% krahasuar me një vit më parë. Dëmet e paguara bruto, përfshirë dhe dëmet objekt Fond Kompensimi, arritën në 6.8 miliardë lekë duke u rritur me 2.45%, në krahasim me vitin 2021.

Në strukturë, tregu vijoi të mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat zënë rreth 92% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto në këtë treg. Ndërsa sigurimet e Jetës, zënë 8% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto. Gjatë vitit 2022, sigurimet vullnetare përbëjnë 37.7%, ndërsa ato të detyrueshme 62.3% të totalit të primeve të shkruara bruto.

AMF, si autoritet mbikëqyrës e rregullator për tregun e sigurimeve ka si objektiv, ndër të tjera, nxitjen dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të tregjeve nën mbikëqyrje.

II. Report on the Financial Position of the Insurance Market

1. Insurance market structure

During 2022, 12 Life and Non-Life insurance companies operated in the insurance market. In the market structure, eight insurance companies operate in the Non-Life market and four in Life market. One of the Non-Life insurance companies is also licensed to carry out reinsurance activities. Following the same trend as in previous years, based on the technical account statement of Non-Life insurance companies, even during 2022 it is noted that the insurance market continues to be dominated by compulsory insurance products, in particular by the domestic MTPL portfolio.

2. Insurance market supervision

Overall, the insurance market appeared stable in terms of key financial soundness indicators, resisting the effects of the pandemic, with good indicators of liquidity, solvency as well as coverage with technical provisions.


The total assets of the insurance market amounted to about ALL 43.6 billion, whereas in terms of the GDP, it turned out to be 2.04% on 31.12.2022. About 88% of the total assets are owned by Non-Life market companies and 12% belong to Life Market companies.

On 31.12.2022, investments amounting to ALL 30.6 billion have continued to dominate the total insurance market assets, accounting for about 70% of the total. The increase of investments compared to the previous year is ALL 3 billion or 11% more year-to-year.

In 2022, the gross written premiums in the insurance market increased by 9.21% year-to-year. Gross paid claims amounted to ALL 6.8 billion, including claims subject to the Compensation Fund, marking an increase by 2.45% compared to 2021.

In terms of structure, the market continued to be oriented towards Non-Life insurance, which accounts for 92% of the total volume of the markets' gross written premiums. Whereas Life insurance occupy 8% of the total volume of gross written premiums. During 2022, voluntary insurance occupied 37.7% and the compulsory insurance 62.3% of the total gross written premiums.

AFSA, as the supervisory and regulatory authority for the insurance market, has among its objective, the promotion and maintenance of the financial stability of the



Kjo do të arrihet nëpërmjet avancimit drejt mbikëqyrjes së plotë me bazë rreziku, forcimit të rregullave të administrimit të rrezikut dhe në harmoni me direktivat përkatëse të BE-së e bazën ligjore në fuqi.

Gjatë vitit 2022 u krye një inspektim i plotë i planifikuar tek shoqëritë e sigurimit të Jetës sipas metodologjisë me fokus rrezikun, bazuar në Manualin e Mbikëqyrjes së Shoqërive të Sigurimit. Inspektimi u përqendrua në vlerësimin e rreziqeve kryesore ndaj të cilave ekspozohen shoqëritë e sigurimit sipas aktiviteteve të biznesit, si dhe administrimi dhe zbutja e këtyre rreziqeve nga drejtimi i lartë i shoqërisë. Inspektimi sipas metodologjisë me fokus rrezikun përqendrohet edhe në përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimit në drejtim të ruajtjes së stabilitetit financiar të saj.

Gjatë vitit 2022, janë kryer shtatë inspektive tematike pranë shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës. Objekti i pesë prej këtyre inspektiveve tematike ishte verifikimi i procedurave dhe afateve për dëmshpërblim, kryesisht për dëmet e sigurimit të detyrueshëm motorik, zbatimi i rekomandimeve të vendimeve të Bordit të Autoritetit, etj. Në këto inspektive u verifikuan zbatimi i kërkesave ligjore dhe rregullatore në fuqi, standardeve dhe procedurave operacionale të administrimit të dokumentacionit të dëmeve, sipas linjës së raportimit dhe nivelit të kompetencave, kryesisht për dëmet pezull dhe të paguara; trajtimi i ankesave për dëmshpërblim; saktësia e raportimit në Autoritet të provigjoneve teknike të dëmeve, etj.

Gjithashtu, janë kryer dy inspektive lidhur me shqyrtimin e procesit të marrjes në sigurim për kontratat e lidhura me përgjegjësinë e ndërtuesit, në zbatim të elementëve dhe kushteve të përgjithshme të miratuara nga Autoriteti, konkretisht: verifikimi i përputhshmërisë së elementëve dhe kushteve të përgjithshme të kontratave të lëshuara gjatë periudhës objekt inspektimi, me bazën ligjore në fuqi; procedurat e brendshme të marrjes në sigurim dhe përgjegjësitë e kontraktuara nga shoqëria; mbulimi me risigurim për kontratat e sigurimit të lidhura me përgjegjësinë e ndërtuesit.

Në përfundim të këtyre inspektiveve, Autoriteti u komunikoi shoqërive gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, si dhe adresoi me Vendime Bordi problematikat e konstatuara dhe masat e nevojshme për t'u ndërmarrë nga shoqëritë e sigurimeve. Zbatueshmëria e rekomandimeve është në vëmendje të Autoritetit si për respektimin e afateve, ashtu edhe për detyrat e lëna.

Gjatë vitit 2022 janë kryer 2 inspektive të përbashkëta me Autoritetin Austriak të Tregjeve (FMA), zhvilluar në Austri dhe Shqipëri, bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit me Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë.

supervised markets. This will be achieved by advancing towards full risk-based supervision, strengthening risk management rules and in line with relevant EU directives and the applicable legal framework.

During 2022, a complete scheduled on-site inspection was conducted in the Life insurance companies following the risk-based methodology, based on the Insurance Companies Supervision Manual. The inspection focused on assessing the main risks which insurance companies are exposed to according to their business activities, as well as on the management and mitigation of these risks by companies' top management. The risk-based inspection methodology also focuses on the Supervisory Board's and senior management's responsibilities of the insurance companies, in view of maintaining their financial stability.

During 2022, seven thematic inspections were conducted at Non-Life insurance companies. The scope under these thematic inspections was the verification of the procedures and deadlines for compensation, mainly for the claims of compulsory motor insurance, the implementation of the recommendations of the decisions of the AFSA's Board, etc. During these inspections, the implementation of legal and regulatory requirements in force, standards and operational procedures for the administration of claim documentation were verified, following the reporting line and level of competences, mainly for pending and settled claims; handling complaints for compensation; accuracy of reporting to AFSA of technical provisions for claims, etc.

In addition, two inspections were performed in terms of the review of the insurance process for contracts related to the builder's liability, in accordance with the general terms and conditions approved by AFSA, specifically: Verification of the compatibility of the general terms and conditions of the contracts issued during the inspection period, with the legal basis in force; internal underwriting procedures and responsibilities contracted by the company; reinsurance coverage for insurance contracts related to builder's liability.

At the end of these inspections, AFSA informed the companies regarding the relevant findings and recommendations, as well as addressed the identified problems and the necessary measures to be taken by the insurance companies through Board Decisions. The viability of the recommendations is under the attention of the AFSA, both for meeting the deadlines and for fulfilling the tasks assigned.

During the year 2022, two joint inspections were carried out with the Austrian Financial Markets Authority (FMA), conducted in Austria and Albania, based on the Memorandum of Understanding signed with FMA.

Objekt i këtyre inspektimeve ishte verifikimi i zbatimit të politikave të Grupit të sigurimit, konkretisht mbi funksionin e zbatueshmërisë; administrimin e asetëve- Investimet; politikave të shpërblimeve të stafit; përshtatjen e politikave të grupit me kuadrin rregullator të AMF-së; shqyrtimin e monitorimit nga grupi të zbatimit të politikave të tij mbi këto funksione; funksionimin e strukturave të dedikuara në shoqëri për zbatimin e këtyre politikave; raportimi tek grupi i sigurimit mbi zbatimin e tyre.

Në fund të procesit të inspektimit, konstatimet dhe rekomandimet e propozuara nga Autoriteti iu komunikuan subjekteve të inspektuara dhe Autoritetit Austriak të Tregjeve.

Risigurimi është forma kryesore e transferimit të rrezikut, në industrinë e sigurimeve në Republikën e Shqipërisë, duke luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe stabilitetin e këtij tregu. Bazuar në kuadrin ligjor dhe aktet rregullatore, të miratuara nga Autoriteti, shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të risigurojnë në një shoqëri risigurimi atë pjesë të rrezikut të siguruar që tejkalon limitin e lejuar prej 10% të vlerës së kapitalit. Shoqëritë e sigurimit nëpërmjet risigurimit zvogëlojnë ekspozimin ndaj rreziqeve të mëdha, përmirësojnë kërkesat për kapital (aftësi pague), rrisin mundësinë për të siguruar më shumë rreziqe, si dhe marrin asistencë teknike dhe financiare nga shoqëritë risigurorese. Aktiviteti i risigurimit është i konsoliduar, ndikuar edhe nga kërkesat e përcaktuara në Rregulloren nr. 85/1, datë 30.09.2015, "Për kriteret e risigurimit", e ndryshuar.

Në bazë të kërkesave ligjore dhe rregullatore, shoqëritë e sigurimit raportojnë në Autoritet programin vjetor të risigurimit. Bazuar në funksionin e tij mbikëqyrës, Autoriteti ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave të lidhura, duke synuar stabilitetin e vazhdueshëm financiar, në lidhje me standardet e mbajtjes së rrezikut nga këto shoqëri risigurimi dhe kriteret e lidhura me cilësinë e risiguroresve.

Marrëveshjet e risigurimit, në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës, janë të formës joproporcionale, kryesisht të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim humbjeje) dhe të formës proporcionale, të tipit *Quota Share/Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risigurorese të formës proporcionale të tipit *Surplus* dhe *Quota Share*.

Viti 2022 ishte një vit i rëndësishëm për Autoritetin në procesin e avancimit të mëtejshëm ligjor e rregullator, në kuadër të integritimit evropian, hapjes së negociatave dhe kryesimit të Kapitullit 9 "Shërbimet Financiare". Autoriteti drejtoi në Bruksel grupin negociator për Kapitullin 9, duke realizuar fillimisht procesin e *screening*

The scope of these inspections was to verify the implementation of the policies of the insurance group, specifically the compliance function; asset management- Investments; staff remuneration policy; the adaptation of the group's policies to the regulatory framework of the AFSA; review of the group's monitoring for the implementation of its policies as regards these functions; the operation of dedicated structures in a company for the implementation of such policies; reporting to the insurance group in terms of their implementation.


Upon finalising the inspection process, the findings and recommendations proposed by AFSA were forwarded to the entities subject to such and to the Austrian Market Authority.

Reinsurance is the main form of risk transfer in the insurance industry in the Republic of Albania, playing an important role in the development and stability of this market. By virtue of the legal framework and the regulatory acts adopted by AFSA, insurance companies are obligated to reinsure in a reinsurance company, that portion of the insured risk that exceeds the allowed limit of 10% of the capital value. By means of reinsurance, insurance companies engage in reducing exposure to major risks, improve capital requirements (solvency), increase chances to insure more risks, and receive technical and financial assistance from reinsurance companies. The reinsurance activity is well consolidated, further influenced by the requirements set out in Regulation no. 85/1, dated 30.09.2015 "On reinsurance criteria", as amended.

By virtue of these legal and regulatory requirements, the insurance companies report to AFSA on their annual reinsurance programme. Based on its supervisory function, AFSA follows on the progress of this programme implementation and its related contracts, aiming at ensuring continuous financial stability of the standards for risk retention by these insurance companies and the criteria related to the reinsurance quality.

The reinsurance agreements in the Non-life insurance portfolio are of a non-proportional form, mainly Excess of Loss type and of proportional form, Quota Share/Surplus type. In Life insurance, the reinsurance coverage is attained by means of reinsurance agreements of a proportional form, Surplus and Quota Share type.

The year 2022 marks an important momentum for AFSA in the process of further legal and regulatory progress, in the framework of European integration, upon the official opening of accession negotiations and as the leading institution of Chapter 9 "Financial Services". AFSA led the negotiating group for Chapter 9 in Brussels, carrying out the screening process related to the legal



lidhur me bazën ligjore e rregullatore, pasuar nga takimi bilateral i mbajtur në datat 13-14 shkurt 2023. Në këtë takim u prezantua në mënyrë të detajuar niveli i përafrimit të kuadrit ligjor e rregullator të tregjeve financiare me direktivat evropiane të fushës. Ekspertët e Komisionit Evropian vlerësuan progresin e bërë dhe angazhimet e marra në Kapitullin 9, sa i përket plotësimit të rekomandimeve dhe përafrimit të *acquis* në fushën e shërbimeve financiare.

Autoriteti kompletoi më tej bazën rregullatore, në zbatim të ligjeve të reja në tregjet nën mbikëqyrje, të përafuara me direktivat evropiane të fushës.

Autoriteti iu nënshtrua gjatë vitit 2022 një procesi rigoroz vlerësimi nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), në lidhje me përputhshmërinë e standardeve dhe praktikave të AMF-së, me Parimet Themelore në Sigurime (ICP).

Në raportin e vlerësimit të përgatitur nga grupi i vlerësimit të IAIS-it, rezultoi përgjithësisht një nivel i lartë i përputhshmërisë me ICP-të, ku nga 24 parime bazë, 10 prej tyre rezultuan plotësisht të përputhura (*Observed*) me parimet ndërkombëtare dhe 12 të tjera me një nivel të lartë përputhshmërie (*Largely observed*). Ky vlerësim përbën një avancim të ndjeshëm kundrejt rezultateve të vlerësimit të vitit 2014, të kryer nga Banka Botërore dhe FMN, në kuadër të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP), ku vetëm një parim bazë rezultoi plotësisht i përputhur (*Observed*) me parimet ndërkombëtare.

Në linjë me rekomandimet e raportit përfundimtar të vlerësimit nga IAIS, Autoriteti do të angazhohet në rishikimin e kuadrit ligjor e rregullator në fushën e sigurimeve, me synim përafrimin e mëtejshëm me Parimet Themelore në Sigurime.

Në vitin 2022, janë kryer takime virtuale midis Autoritetit dhe kolegjeve mbikëqyrëse të grupeve të sigurimeve Uniqa Insurance Group dhe Vienna Insurance Group. Këto kolegje janë në funksion të mbikëqyrjes efektive të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në lidhje me ecurinë e aktivitetit të tyre. Pjesë e raportimit ishin rreziqet që karakterizojnë funksionimin e tyre në tregun shqiptar të sigurimit, si dhe sjelljen në vëmendje të çështjeve dhe problematikave të konstatuara nga mbikëqyrja.

Në zbatim edhe të Strategjisë së Autoritetit 2018–2022, përfaqësues të tij dhe Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) zhvilluan edhe gjatë vitit 2022 kolegjin mbikëqyrës për një grup sigurimesh me kapital vendas që ushtron aktivitet edhe në Republikën e Kosovës, në bazë të Udhëzimit Metodologjik “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”.

and regulatory basis as first step, followed by the bilateral meeting held on February 13th - 14th, 2023. In this meeting, the level of alignment of the legal and regulatory framework of the financial markets with the European directives in the field was introduced in detail. The experts of the European Commission evaluated the progress achieved and the commitments undertaken in the framework of Chapter 9, regarding the fulfilment of the recommendations and the approximation of the *acquis* in the field of financial services.

AFSA further completed the regulatory framework, in implementation of the new laws on the markets under supervision, aligned with the European directives in the field.

During 2022, AFSA was subject to a rigorous assessment process by the International Association of Insurance Supervisors (IAIS), regarding the compliance of AFSA's standards and practices with the Insurance Core Principles (ICP).

The assessment report prepared by IAIS Evaluation Group, revealed a high level of observance with ICPs, out of 24 insurance core principles, 10 principles were observed, and 12 were largely observed. This assessment marked a noteworthy improvement compared to the previous evaluation conducted by the World Bank and the IMF back in 2014 as part of the Financial Sector Assessment Program (FSAP), where only one core principle was observed.

AFSA is committed in the review of the legal and regulatory framework in the field of insurance, with the aim of further alignment with the Insurance Core Principles in line with the recommendations of the final assessment report by IAIS.

In 2022, virtual meetings took place between AFSA and the supervisory colleges of the insurance groups “Uniqa Insurance Group” and “Vienna Insurance Group”. The supervisory college's objective is the effective supervision of insurance and reinsurance companies, through the exchange of information concerning the progress of their activity. Part of the reporting were the risks that characterise their operations in the Albanian market, as well as bringing to their attention the issues and problems noticed during supervision.

In compliance with AFSA's strategy 2018-2022, representatives of AFSA and the Central Bank of Kosovo (CBK) held even during 2022 the supervisory college for an insurance group with local capital operating in the Republic of Kosovo, based on the Methodological Guideline “On Insurance groups supervision”. The purpose

Qëllimi i këtij kolegji është shkëmbimi i informacionit në funksion të mbikëqyrjes efektive në nivel grupi për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit, të cilat kanë investime apo degë të tyre në vende të huaja. Çështjet kryesore të trajtuara në këtë kolegji kanë qenë ndër të tjera vlefshmëria reciproke e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, detyrimet reciproke mbi praktikën e dëmeve apo trajtimin dhe pagesën e dëmeve, ndikimi i pandemisë Covid-19 në treguesit financiarë të shoqërive të grupit, etj.

3. Analiza e ecurisë të tregut të sigurimeve¹

Ecuria e treguesve kryesorë financiarë të tregut të sigurimeve për vitin 2022, paraqitet si më poshtë:

- **Totali i primeve të shkruara bruto**, për tregun e sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës në 31.12.2022 është 21 miliardë lekë duke shënuar një rritje prej 1.77 miliardë lekë ose 9.21% krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes së volumit të primeve të shkruara bruto në masën 1.5 miliard lekë ose rreth 8.51% për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës dhe rritje prej 256 milionë lekë ose rreth 18% në tregun e sigurimeve të Jetës.
- **Treguesi i Mjaftueshmërisë** së Kapitalit për tregun e Jo-Jetës në 31.12.2022 është i mjaftueshëm, me 4.1 miliardë lekë mbi nivelin e kërkuar, ose 196.4%. Për tregun e Jetës treguesi është sërish i mjaftueshëm me rreth 347 milionë lekë mbi nivelin e kërkuar, ose 123.4%.
- **Treguesi i Aktiveve në mbulim të Provigjoneve Teknike** për tregun e sigurimeve për vitin 2022 është në masën 132%, duke shënuar rritje krahasuar me vitin 2021 kur ky tregues ishte 130%. Në vitin 2022 ky tregues për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës është 133.6%, dhe paraqitet me rritje krahasuar me 130% në fund të vitit 2021. Për tregun e Jetës ky tregues është 118%, dhe paraqitet me rënie krahasuar me 124% që ishte në fund të vitit 2021.
- **Treguesit e Rentabilitetit ROE (Kthimi nga kapitalet e veta) dhe ROA (Kthimi nga aktivet)** për vitin 2022, janë përkatësisht ROE në nivelin 12.19% nga 4.7% në vitin 2021 dhe ROA 3.87% nga 1.51% në vitin 2021.
- **Totali i aktivitetit të tregut të sigurimit** për periudhën 31.12.2022, sipas pasqyrave financiare, është rreth

of this college is the exchange of information in view of an effective supervision at group level for the local insurance and reinsurance companies, which have invested or have their branches established in foreign countries. The main issues addressed in this college were, inter alia, the mutual validity of compulsory motor insurance policies for liabilities toward third parties, mutual liabilities over claims or claims handling and payment, the impact of the Covid-19 pandemic on financial indicators of group companies and others.


3. Analysis of the insurance market performance¹

The progress of the 2022 financial indicators of the insurance market is as follows:

- **The total of gross written premiums** for Life and Non-Life insurance market as of 31.12.2022 is ALL 21 billion, marking a decrease of ALL 1.77 billion or 9.21% compared to the previous year. Such increase is due to the increase of the gross written premiums volume by ALL 1.5 million or about 8.51% in the Non-Life insurance market and the increase by ALL 256 million or about 18% in the Life insurance market.
- **The Capital Adequacy Indicator** for the Non-Life insurance market as of 31.12.2022 is sufficient, with ALL 4.1 billion, or 196.4% above the required level. For the Life insurance market, the indicator also seems to be sufficient, with about ALL 347 million, or 123.4%, above the required level.
- **The Assets Indicator covering Technical Provisions** for the insurance market for 2022 is 132%, marking an increase compared to 2021, when such indicator was 130%. In 2022, this indicator for the Non-Life insurance market is 133.6%, marking an increase compared to 130% at the end of 2021. For the Life insurance market, this indicator is 118%, marking a decrease compared to 124% at the end of 2021.
- **ROE (Return on Equity) and ROA (Return on Assets) Profitability Indicators** for 2022 are as follows: ROE at 12.19% compared to 4.7% in 2021 and ROA at 3.87% compared to 1.51% in 2021.
- **Total assets of the insurance market** for the period as of 31.12.2022, based on the financial statements,

¹Treguesit financiarë pasqyrojnë të dhënat pas certifikimit të raporteve të audituara dhe analizës financiare të shoqërive të sigurimit.

¹ Financial indicators reflect data after the certification of audited reports and the financial analysis of insurance companies.



43.6 miliardë lekë dhe ka pësuar rritje në vlerën 3 miliardë lekë krahasuar me 31.12.2021. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare” në të dy sektorët, e Jo-Jetës dhe Jetës.

- Në vitin 2022 vihet re një rritje e vlerës së **provigjoneve teknike bruto** në nivel tregu, me 7.7% ose rreth 1.7 mld lekë, e ndikuar nga të dy aktivitetet. Për aktivitetin e Jo-Jetës rritja rezultoi të jetë rreth 1.5 miliard lekë ose 7.7%, ndërsa për shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në klasat e Jetës rezultoi një rritje e provigjoneve teknike bruto me rreth 179 milion lekë ose 8%.
- **Rezultati financiar neto** i tregut të sigurimeve për vitin 2022 është pozitiv në vlerën 1.6 miliardë lekë. Rezultati financiar në fund të vitit 2022 për shoqëritë e sigurimit ka pësuar rritje me rreth 1 miliardë lekë, krahasuar me vitin 2021. Rezultati financiar në tregun e Jo-Jetës për vitin 2022 është ndikuar kryesisht nga rritja e primeve të shkruara bruto, të cilat kanë qenë në nivelin 19.4 miliardë lekë, ndërkohë që shpenzimet operative janë mbajtur në nivele të ngjashme me vitin e kaluar. Ecuri pozitive kanë patur dhe të ardhurat nga investimet, të cilat kanë rezultuar në vlerën 444 milionë lekë, ndikuar kryesisht nga rritja e normave të interesit. Gjithashtu edhe në tregun e Jetës rezultati financiar, është ndikuar nga rritja e primeve të shkruara bruto, të cilat kanë qenë në nivelin 1.7 miliardë lekë.
- Niveli ende i ulët i **raportit të primeve të shkruara bruto ndaj PBB**, në masën 0.99%, vazhdon të përforcojë pritshmërinë se tregu shqiptar i sigurimeve paraqet potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm.

Edhe gjatë vitit 2022, me qëllim vlerësimin e shëndetit financiar të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, janë përdorur testet e paralajmërimit të hershëm (*Early Warning Test*). Këta tregues financiarë i shërbejnë evidentimit të problemeve që mund të bëhen shkak për përkeqësimin e një ose disa parametrave të operatorëve në treg. Ruajtja e qëndrueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje dhe mbrojtja e konsumatorit janë ndër objektivat kryesore të veprimtarisë së AMF-së. Veprimet e Autoritetit me qëllim parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve në këtë drejtim, përfshijnë monitorimin e praktikave të tregut në mënyrë të vazhdueshme dhe ndërhyrjen me theks të veçantë në ato aktivitete, të cilat janë të ekspozuara ndaj rrezikut të lartë apo që mund të sjellin cenim të interesave të konsumatorëve.

amount to about ALL 43.6 billion, marking an increase of ALL 3 billion compared to 31.12.2021. This increase is mainly due to the increase in the item “Investments in land, buildings and financial investments” in both sectors, Non-Life and Life.

- In 2022, an increase was observed in the value of **gross technical provisions** at market level by 7.7%, or approximately ALL 1.7 billion, influenced by both activities. For the Non-Life activity, the increase was approximately ALL 1.5 billion or 7.7%, whereas for companies operating in Life category, the gross technical provisions increased by about ALL 179 million or 8%.
- **The net financial result** of the insurance market for 2022 is positive, amounting to ALL 1.6 billion. By the end of 2022, the financial result for insurance companies increased by about ALL 1 billion compared to 2021. The financial result in the Non-Life insurance market for 2022 was particularly influenced by the increase in gross written premiums, which accounted for ALL 19.4 billion, whereas operating expenses remained at the same levels as last year. Investment income also had a positive performance, which amounted at ALL 444 million, mainly influenced by the increase in interest rates. Moreover, in the Life insurance market, the financial result was affected by the increase in gross written premiums, which accounted for ALL 1.7 billion.
- **The level of gross written premiums to GDP ratio** which still remains low at 0.99%, continues to reinforce expectations that the Albanian insurance market represents great potential for further development.

Even during 2022, in view of assessing the financial soundness of Non-Life insurance companies, Early Warning Tests were used. These financial indicators serve to identify issues that may cause the deterioration of one or more parameters of market operators. Maintaining the sustainability of financial markets under supervision and consumer protection are among the main objectives of AFSA's activity. Actions undertaken by AFSA to prevent and eliminate violations in this regard include monitoring of market practices on a continuous basis and intervention with particular emphasis on those areas exposed to high risk or that may prejudice the consumers interests.

Gjatë vitit 2022, rekomandimet e Autoritetit për tregun e sigurimeve lidhen kryesisht me:

- Ruajtjen dhe arritjen e aftësisë paguese të disa shoqërive, sipas dispozitave të nenit 80 të Ligjit 52/2014;
- Ruajtjen dhe arritjen e treguesit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, sipas dispozitave të nenit 96 të Ligjit 52/2014;
- Plotësimin e kërkesave të Bordit të AMF-së në lidhje me pasqyrimin e saktë në pasqyrat financiare dhe shlyerjen e detyrimeve që lidhen me dëmet e Fondit të Kompensimit;
- Administrimin e rreziqeve të kontraktuara nga shoqëritë e sigurimit në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi;
- Vlerësimin dhe trajtimin e dëmeve, si edhe zbatimin e kërkesave ligjore në drejtim të provigjonimit të dëmeve në proces gjyqësor, për një pasqyrim sa më të drejtë të nivelit të rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë;
- Ndjekjen dhe zbatimin e rregulloreve të miratuara nga Autoriteti lidhur me trajtimin dhe pagesën e dëmeve;
- Raportimin në Autoritet të informacionit të kërkuar sipas kërkesave ligjore në fuqi; etj.

AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbyshjen e kërkesës ligjore mbi Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Fondi i Garancisë është investuar në “depozita qëllimore” në bankat tregtare dhe letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

III. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Pensioneve Private Vullnetare

1. Struktura e tregut të Pensioneve Private Vullnetare

Struktura e tregut të pensioneve private vullnetare për vitin 2022 përbëhet nga katër fonde pensioni, të cilat administrohen nga katër shoqëri të ndryshme administruese si Raiffeisen Invest sh.a., Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a., Credins Invest sh.a dhe Albsig Invest sh.a. Funksionin e depozitarit për fondet e pensionit e kryejnë First Investment Bank sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a. dhe Tirana Bank sh.a.

Gjatë 2022, Autoriteti ka miratuar dy fonde të reja të pensionit vullnetar, një prej të cilëve ka filluar veprimtarinë në janar 2023.

During 2022, the AFSA's recommendations for the insurance market mainly related to:

- *Maintainance and achievement of the solvency of some companies, as provided for in Article 80 of Law 52/2014;*
- *Maintainance and achievement of the assets' indicators, covering technical provisions, as provided for in Article 96 of Law 52/2014;*
- *Meeting of the AFSA Board requirements in terms of accurate reflection in the financial statements and settlement of claims related to the Compensation Fund claims;*
- *Management of risks contracted by insurance companies in compliance with the applicable legal requirements;*
- *Evaluation and handling of claims, as well as compliance with the legal requirements for the provision of claims in court proceedings, for a fair reflection of the level of risk contracted by companies;*
- *Follow-up and implementation of regulations approved by AFSA, regarding claims treatment and payment;*
- *Reporting to AFSA the required information, in compliance with the applicable legal requirements and others.*


AFSA has consistently tracked the compliance with the legal requirement on the guarantee fund of insurance companies and the implementation of its investment rules. The Guarantee Fund is invested in “special-purpose deposits” in commercial banks and securities issued by the Bank of Albania, in compliance with the legal requirements in force.

III. Report on the Financial Position of the Voluntary Private Pension Market

1. Voluntary Private Pensions Market Structure

The structure of the voluntary private pensions market for 2022 consists of four pension funds, which are managed by four different managing companies i.e. Raiffeisen Invest sh.a., Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a., Credins Invest sh.a. and Albsig Invest sh.a. The function of the depository for pension funds is performed by First Investment Bank sh.a., American Bank of Investments sh.a. and Tirana Bank sh.a.

During 2022, AFSA approved two new voluntary pension funds, one of which started operating in January 2023.



2. Mbikëqyrja e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare

Mbikëqyrja e tregut të pensioneve private vullnetare ushtrohet nga AMF mbështetur në Ligjin 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, ndryshuar me Ligjin 54/2014, në Ligjin 10197 datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Për tregun e fondeve të pensionit vullnetar, Autoriteti gjatë vitit 2022 ka kryer inspektime tematike pranë dy shoqërive administruese. Fokusi i këtyre inspektimeve ka qënë vlerësimi i zbatimit të detyrimeve ligjore dhe rregullatore në lidhje me kryerjen e veprimtarive promovionale për fondet nën administrim dhe vlerësimin e aseteve të tyre. Metodologjia e përdorur gjatë inspektimit tematik, përfshiu mbledhjen e informacionit të nevojshëm paraprak në lidhje me objektin e inspektimit, kryerjen e intervistave dhe verifikimin në vend të këtyre informacioneve. Pas inspektimit janë lënë rekomandime, për të cilat shoqëritë administruese kanë marrë masat për zbatimin e tyre.

3. Treguesit teknikë e financiarë të Tregut të Fondeve të Pensioneve Vullnetare

Gjatë vitit 2022, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre katër fonde pensioni. Ky treg ka patur tendencë në rritje, e shprehur kjo në rritjen e vlerës neto të aseteve dhe numrit të anëtarëve.

Në fund të vitit 2022, totali i aseteve neto të fondeve të pensioneve private arriti në 5.7 miliardë lekë me një rritje prej 24.32% dhe numri i anëtarëve arriti në 36,518 me një rritje prej 8.78% në krahasim me fundin e vitit 2021.

Gjatë vitit 2022 investimet e tregut të Fondeve të Pensionit Vullnetar janë kryer në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Vlera e investimeve të këtij tregu në 31.12.2022 është 5.49 miliardë lekë, duke zënë një peshë prej 96.1% ndaj totalit të aktiveve të tregut të fondeve të pensionit. Krahasuar me 31.12.2021 këto investime janë rritur me 30.57%. Gjatë vitit 2022, investimet e tregut të fondeve të pensionit përbëhen nga obligacione të Republikës së Shqipërisë me afat maturimi 5, 7, 10 dhe 15 vjeçar. Investimet në obligacione të qeverisë së RSH me afat maturimi 10 vjeçar zënë peshën më të madhe dhe përbëjnë 59.81% të totalit të investimeve të këtij tregu.

Shoqëritë administruese të fondeve të pensionit Raiffeisen Invest sh.a, Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a, Credins Invest sh.a dhe Albsig Invest sh.a e publikojnë dhe e përditësojnë vlerën e kuotës së pensionit sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatore në fuqi.

2. Voluntary Private Pensions Market Supervision

The supervision of the voluntary private pensions market is performed by AFSA pursuant to Law 9572, dated 03.07.2006, “On the Financial Supervisory Authority”, as amended by Law 54/2014 and Law 10197, dated 10.12.2009, “On Voluntary Pension Funds”; as well as its applicable by-laws.

In terms of the voluntary pension funds market, during 2022 AFSA has carried out thematic inspections of two managing companies. These inspections mostly focus on the assessment of the implementation of legal and regulatory obligations as regards the performance of promotional activities for funds under administration and assessment of their assets. The methodology used during the thematic inspection included the collection of the necessary preliminary information relevant to the scope of the inspection, conducting of the interviews and on-site information verification. After the inspection, a set of recommendations were issued, for which the managing companies have taken the respective measures for their implementation.

3. Financial and technical indicators of the Voluntary Pension Fund Market

During 2022, four pension funds exercised their activity in the voluntary private pension market. This market has experienced an upward trend, reflected as an increase in the assets net value and in the number of members.

At the end of 2022, the total net assets of private pension funds accounted for ALL 5.7 billion, marking an increase of 24.32%, and the number of members reached 36,518, with an increase of 8.78% compared to the end of 2021.

During 2022, voluntary pension funds market investments were performed in accordance with the applicable legal basis. The investment value of this market as of 31.12.2022 is ALL 5.49 billion, accounting for a share of 96.1% of the pension funds market total assets. Compared to 31.12.2021, these investments have increased by 30.57%. During 2022, investments in the Pension Fund Market consist of Treasury Bonds of the Republic of Albania with a maturity term of 5, 7, 10 and 15 years. Investments in RoA government bonds with a 10 year-term maturity occupy the largest share and constitute 59.81% of the total investments of this market.

The Pension Funds Managing Companies Raiffeisen Invest sh.a, Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a, Credins Invest sh.a and Albsig Invest sh.a publish and update the value of the pension shares in compliance with the relevant applicable legal basis and regulations in force.

IV. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Fondeve të Investimeve

1. Struktura e tregut të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Gjatë vitit 2022, në tregun e SIK ushtruan aktivitetin e tyre 13 fonde investimi nga të cilat 11 me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike dhe 2 fonde alternative. Fondet e investimit janë administruar nga pesë shoqëri administruese, tre nga të cilat kryejnë veprimtarinë e administrimit për SIK dhe për fondet e pensionit vullnetar, ndërkohë që dy shoqëritë e tjera kryejnë veprimtarinë e administrimit vetëm për SIK.

2. Mbikëqyrja e tregut të fondeve të investimeve

Mbikëqyrja e tregut të fondeve të investimit gjatë vitit 2022 është ushtruar nga AMF mbështetur në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, Ligjin 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Gjatë vitit 2022, Bordi i Autoritetit në përgjigje të krizës ekonomike globale shkaktuar si pasojë e luftës Rusi-Ukrainë ndërmori disa masa të rëndësishme për përballimin e situatës. Vendimi i Bordit të AMF-së nr. 88 datë 31.03.2022, kishte fokus kryesor mbikëqyrjen e kujdesshme të ecurisë së fondeve të investimit dhe rritjen e frekuencës së raportimit të treguesve kryesorë, si shlyerjet neto, provat e rezistencës dhe treguesit e likuiditetit.

Autoriteti, nëpërmjet vendimit nr. 186, datë 29.09.2022 me të cilin miratoi një ndryshim në rregulloren nr. 106 datë 30.06.2021, i krijoi mundësinë tregut të fondeve të investimit të investojë me norma më të larta kthimi, asetet likuide që mbahen të painvestuara dhe si pasojë mundësinë e ndikimit pozitiv të këtyre investimeve të reja në performancën e fondeve të investimit.

Gjatë vitit 2022, Autoriteti ka kryer inspektime tematike pranë tre shoqërive administruese, të cilat administrojnë sipërmarrje të investimeve kolektive. Fokusi i këtyre inspektimeve ka qënë zbatimi i detyrimeve ligjore dhe rregullatore në lidhje me kryerjen e veprimtarive promovionale për fondet nën administrim, vlerësimin e aseteve dhe administrimin e likuiditetit të këtyre fondeve. Metodologjia e përdorur gjatë këtij inspektimi tematik, përfshiu mbledhjen e informacionit të nevojshëm paraprak në lidhje me objektin e inspektimit, kryerjen e intervistave dhe verifikimin në vend të këtyre informacioneve. Në përfundim të inspektimeve, Autoriteti u komunikoi shoqërive gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Vendimet e Bordit lidhur

IV. Report on the Financial Position of the Investment Funds Market

1. Collective Investment Undertakings Market Structure

During 2022, 13 investment funds exercised their activity in the CIU market, of which 11 open-ended investment funds with public offering and 2 alternative investment funds. Investment funds are managed by five managing companies, three out of which perform the management activity for both CIUs and voluntary pension funds, whereas the other two companies perform the management activity only for CIUs.

2. Investment funds market supervision

The supervision of the investment funds market is exercised by AFSA pursuant to Law No. 9572, dated 03.07.2006 "On the Financial Supervisory Authority", as amended, Law 56/2020 "On Collective Investment Undertakings", as well as the by-laws in its implementation, as well as its applicable by-laws.

During 2022, in response to the global economic crisis caused by the war between Russia and Ukraine, the AFSA Board took several important measures to cope with the situation. Decision of the AFSA Board no. 88, dated 31.03.2022, mostly focused on the diligent supervision of the performance of investment funds and the increase in the frequency of reporting of the key indicators, such as net repayments, stress tests and liquidity indicators.

AFSA, through Decision no. 186, dated 29.09.2022, which adopted an amendment to Regulation no. 106, dated 30.06.2021, enabled the investment funds market to invest with higher rates of return, uninvested liquid assets and, as a result, paved the way to a positive impact of these new investments on the performance of investment funds.

During 2022, AFSA has carried out thematic inspections of three managing companies, which are in charge of the management of collective investment undertakings. These inspections mostly focused on the implementation of legal and regulatory obligations as regards the performance of promotional activities for the funds under administration, the assessment of assets and the administration of the liquidity of such funds. The methodology used during this thematic inspection included the collection of the necessary preliminary information relevant to the scope of the inspection, conducting of the interviews and on-site information verification. Upon completion of the inspections, AFSA communicated the relevant findings and recommendations to these managing companies. The

me masat e nevojshme për t'u ndërmarrë nga shoqëritë administruese, po ndiqen në vijimësi për zbatueshmërinë e tyre.

3. Treguesit Kryesorë të Tregut të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive më 31.12.2022

Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (SIK) vijon të përfaqësojë një pjesë të rëndësishme të tregjeve nën mbikëqyrje, pavarësisht presioneve inflacioniste dhe luhatjeve në treg gjatë vitit 2022, ndikuar kryesisht nga pasiguritë në tregjet financiare ndërkombëtare.

